



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.6, Nenit 14, paragrafi 2, nën paragrafi 2.6 dhe 2.16, Nenit 25, Nenit 32 dhe Nenit 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit dhe të tregut (Rregulla për Çmimet e OST/OT-së);
- Kërkesën e KEDS të dorëzuar për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Tarifave të Energjisë Elektrik pas shpërthimit në TC Kosova A;
- Vendimin V_638_2014 për të Hyrat Maksimale të Lejuara për Furnizuesin Publik pwr vitin rregullativ 2014
- Vendimin nr. V_644_2014 për të Hyrat Maksimale të Lejuara për Furnizuesin Publik pas shqyrtimit të Jashtëzakonshëm;
- Dispozitat e Nenit 4 dhe Nenit 9 të Licencës së OSSH-së;
- Dispozitat e Nenit 2.1 paragrafi 2.1.3; Nenit 4.2.1, Nenit 4.5.2 Nenit 4.8.4, Nenit 4.9.1, Nenit 4.10.1 Nenit 4.10.4 Nenit 4.10.7; Nenit 5.5.1 dhe 5.9.3 të Kodit te matjes;
- Dispozitat e Nenit 2.4.1 dhe 2.11.3 të Kodit te Shpërndarjes;

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, **në seancën e mbajtur më 29 Gusht 2014 nxori këtë:**

VENDIM

- I. **APROVOHEN** tarifat dhe ngarkesat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar për vitin relevant tarifor SHTE8 që do të zbatohen nga i licencuari nga data 1 shtator 2014.

ARSYETIM

- ✚ Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), me datë 4 gusht 2014 ka pranuar nga KEDS kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm të tarifave të rregulluara me pakicë;



- ✚ Për vendosjen e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në ueb faqen e saj si dhe takimet sqaruese që ka realizuar me të licencuarit gjatë periudhës qershor- gusht 2014. Këto dokumente janë:
- Raport Vlerësimi-Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara të Gjeneratorit të Rregulluar, i publikuar me datën 15 maj 2014;
 - Raporti Përfundimtar- Kalkulimi i Kostos me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar me datën 24 qershor 2014;
 - Raporti Përfundimtar- Kalkulimet e MAR-it të KOSTT SH.A, i publikuar me datën 24 qershor 2014;
 - Raporti Përfundimtar- Kalkulimet e MAR-it të OSSH-së, i publikuar me datën 24 qershor 2014;
 - Përgjigjet ndaj Komenteve të KEDS-it - Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara, i publikuar me datën 24 qershor 2014.
 - Raporti përfundimtar -Kalkulimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale të Furnizuesit Publik me Energji Elektrike (FPPE), i publikuar më datën 24 Qershor 2014.
 - Raporti Konsultativ- Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm i tarifave të energjisë elektrike në kuadër të SHTE8-Vlerësimi i ndikimit në të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe rishqyrtimi tarifor, i publikuar më datën 13 Gusht 2014.
 - Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm i Tarifave të energjisë elektrike në kuadër të SHTE8 - Përgjigjet në komente, i publikuar më datën 29 Gusht 2014.
 - Përcaktuesit e faturimit të aprovuara nga ZRRE për vitin Relevant tarifor 2014-2015.

Gjatë përcaktimit të tarifave me pakicë të energjisë elektrike, ZRRE-ja merr parasysh Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për të mbuluar kostot e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve të rregulluara si dhe konsumin e vlerësuar për secilën kategori tarifore përmes së cilave do të mbulohet MAR-i. Përcaktuesit e faturimit të aprovuara nga ZRRE me vendimin V_638_2014 për vitin Relevant tarifor 2014-2015 mbesin në fuqi.

- II. Duke marrë parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje dhe shqyrtimin e të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III. Struktura e tarifave me pakicë e energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, e cila do të zbatohet nga data 1 shtator 2014, përkatësisht në vitin Relevant tarifor SHTE8 është si në tabelën e mëposhtme:



Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Të miratuara 2014	
					Sezona e lartë	Sezona e ulët
					1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator
0-1	220kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		200.75	
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		15.88	
		Energjia aktive (P)	€/kWh		2.45	
0-2	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		100.38	
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		6.70	6.70
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.78	2.30
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.23	1.89
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.00	0.00		
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		13.27	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		6.96	6.96
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	8.13	3.52
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.30	3.17
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.79	0.79		
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		5.49	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.99	5.99
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	9.11	4.06
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.91	3.70
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.79	0.79		
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.09	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		3.49	3.49
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	10.12	5.62
			€/kWh	Tarifë e Ulët	6.38	5.30
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.79	0.79		
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.50	
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifë e vetme	12.46	8.06
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	15.00	9.83
			€/kWh	Tarifë e Ulët	7.50	4.91
5	0.4kV matësi 2 tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.50	
		Energjia aktive (P) për konsum:				
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	5.55	3.99
			€/kWh	Tarifë e Ulët	2.79	1.99
		200-600kWh/muaj (Blloku i dytë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.70	5.51
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.86	2.76
>600 kWh/muaj (Blloku i tretë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	11.17	8.00		
€/kWh	Tarifë e Ulët	5.58	4.01			
6	0.4kV matësi 1 tarifor (1-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.50	
		Energjia aktive (P) për konsum:				
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€/kWh	Tarifë e vetme	4.96	3.54
		200-600kWh/muaj (Blloku i dytë):	€/kWh	Tarifë e vetme	6.86	4.91
>600 kWh/muaj (Blloku i tretë):	€/kWh	Tarifë e vetme	9.95	7.14		
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar:				
		<200 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		25.75	
		200-600 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		46.60	
>600 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		78.53			
8	Ndriçim publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.50	
		Energjia aktive (P) për konsum:	€/kWh	Tarifë e vetme	10.09	

Tarifa e lartë aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë sezonit të lartë dhe prej orës 08:00 - 23:00 gjatë sezonit të ulët.


Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korrespondon me $\cos(\Phi)=0.95$





- IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjeve midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- V. Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga Furnizuesi Publik duke filluar nga 1 shtator 2014 deri në shqyrtimin e rregullt dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, tridhjetë (30) ditë, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar